

**Emanuelle Adriatic Energy Limited – Dega në  
Shqipëri e Emanuelle Adriatic Energy Limited  
Qipro**

**Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

## **Përmbajtja:**

	<b>Faqe</b>
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021	3
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën nga 01 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për periudhën nga 01 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021	5
Pasqyra e flukseve monetare për periudhën nga 01 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021	6
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	7 – 14


# Emanuelle Adriatic Energy Limited – Dega në Shqipëri e Emanuelle Adriatic Energy Limited Qipro


Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktivt afatshkurtra</b>			
TVSH e arkëtueshme	4	901,540	901,540
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>901,540</b>	<b>901,540</b>
<b>Aktive afatgjata</b>			
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		-	-
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>901,540</b>	<b>901,540</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme	5	253,596	103,908
Detyrime tatimore	6	8,370	8,370
Të tjera të pagueshme	7	6,936,370	6,478,827
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>7,198,336</b>	<b>6,591,105</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		-	-
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>7,198,336</b>	<b>6,591,105</b>
<b>KAPITALI</b>			
Humbje e mbartur	8	(5,689,565)	(4,922,049)
Humbje e periudhes		(607,230)	(767,516)
<b>Totali i kapitalit (neto)</b>		<b>(6,296,796)</b>	<b>(5,689,565)</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>901,540</b>	<b>901,540</b>

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021 u aprovuan nga Emanuelle Adriatic Energy Limited dhe u nënshkruan si më poshtë:

  
Loucas Haviaras  
Perfaqësues ligjor

  
Ilda Duhaxhiu  
Specialiste Kontabiliteti

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 14 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Emanuelle Adriatic Energy Limited – Dega në Shqipëri e

## Emanuelle Adriatic Energy Limited Qipro

### Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

për periudhën nga 01 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shë nime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<b>TE ARDHURAT E SHFRYTEZIMIT</b>			
Të ardhurat nga aktiviteti		-	-
Te ardhura te tjera		-	-
<b>SHPENZIME OPERATIVE</b>			
Kosto te shfrytezimit		-	-
Shpenzime personeli	9	(100,440)	(100,440)
Shpenzime të tjera	10	(672,097)	(575,496)
		<b>(772,537)</b>	<b>(675,936)</b>
<b>FITIMI NGA AKTIVITETI OPERATIV</b>		<b>(772,537)</b>	<b>(675,936)</b>
Shpenzime financiare neto		-	-
Humbje neto nga kurset e kembimit	11	165,307	(91,581)
<b>Totali i shpenzimeve financiare, neto</b>		<b>165,307</b>	<b>(91,581)</b>
<b>FITIMI PARA TATIMIT</b>		<b>(607,230)</b>	<b>(767,516)</b>
Shpenzimi tatim-fitimit	12	-	-
<b>FITIM/(HUMBJA) E VITIT</b>		<b>(607,230)</b>	<b>(767,516)</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Fitimi gjithëpërfshirës për vitin</b>		<b>(607,230)</b>	<b>(767,516)</b>

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve dhe te ardhurave gjithëpërfshirëse duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 14 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.



# Emanuelle Adriatic Energy Limited – Dega në Shqipëri e Emanuelle Adriatic Energy Limited Qipro

Pasqyra e ndryshimeve në kapital  
për periudhën nga 01 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapitali i nënshkruar i paguar	Rezerva rivleresimi	Fitime të pashpërndara (Humbje të Akumuluar)	Totali
<b>Më 31 dhjetor 2019 (i riparaqitur)</b>			<b>(4,922,049)</b>	<b>(4,922,049)</b>
Fitimi (Humbja) për periudhën	-	-	(767,516)	(767,516)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
<b>Fitimi gjithëpërfshirës për vitin</b>	-	-	<b>(767,516)</b>	<b>(767,516)</b>
Divident i paguar	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	-	-	<b>(5,689,565)</b>	<b>(5,689,565)</b>
Fitimi (Humbja) për periudhën	-	-	(607,230)	(607,230)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
<b>Fitimi gjithëpërfshirës për vitin</b>	-	-	<b>(607,230)</b>	<b>(607,230)</b>
Divident i paguar	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	-	-	<b>(6,296,795)</b>	<b>(6,296,795)</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 14 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Emanuelle Adriatic Energy Limited – Dega në Shqipëri e Emanuelle Adriatic Energy Limited Qipro

## Pasqyra e flukseve monetare

për periudhën nga 01 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi përpara tatim-fitimit	(607,230)	(767,516)
<i>Rregullime per:</i>		
Shpenzime amortizimi	-	-
	<b>(607,230)</b>	<b>(767,516)</b>
<i>Fluksi nga veprimtaritë operative para ndryshimeve në kapitalin qarkullues:</i>		
Pakësime/(rritje) në llogari të arkëtueshme	-	(103,788)
Rritje në të tjera të arkëtueshme	-	-
Rritje/(pakësime) në llogari të pagueshme	607,230	1,621
Rritje/(pakësime)në të tjera të pagueshme	-	6,478,827
<b>Flukse monetare te gjeneruar nga/ (përdorur në) veprimtaritë operative</b>	<b>0</b>	<b>5,609,144</b>
Tatim fitimi i paguar		
<b>FLUKSE MONETARE NETO GJENERUAR NGA/ (PËRDORUR NË) VEPRIMTARITË OPERATIVE</b>	<b>0</b>	<b>5,609,144</b>
<b>FLUKSE MONETARE NGA VEPRIMTARITË INVESTUES E PAKËSIM/(RRITJE) NETO E MJETEVE MONETARE NGA VEPRIMTARITË INVESTUES E</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>FLUKSE MONETARE NGA VEPRIMTARITË FINANCUES E</b>		
Financim nga shoqëria meme	-	(5,609,144)
<b>PAKËSIM/(RRITJE) NETO E MJETEVE MONETARE NGA VEPRIMTARITË FINANCUES E</b>	<b>-</b>	<b>(5,609,144)</b>
<b>RRITJE NETO E MJETEVE MONETARE DHE EKVIVALENTEVE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Efkti i kurseve te kembimit në Mjete monetare dhe Ekuivalentë	-	-
<b>Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë në fund të vitit</b>	<b>-</b>	<b>0</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 14 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Emanuelle Adriatic Energy Limited (referuar si “Emanuelle” ose “Shoqëria”) është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më datë 24 gusht 2012 si degë e shoqërisë së huaj Emanuelle Adriatic Energy Limited Qipro. Shoqëria është e regjistruar me Degën e Tatimeve dhe Taksave Tiranë me NIPT/NUIS L22024003A.

Aktiviteti i shoqërisë është i lidhur kerkimin, zhvillimin dhe prodhimin perfs hire ketu perpunimin e naftes.

Ne baze te legjislacionit shqiptar, dega e nje shoqërie te huaj eshte e përjashtuar nga detyrimi per te derdhur kapital aksionar fillestar.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është Loucas Haviaras.

Adresa e Shoqërisë është Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, kati II Tiranë.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 është 1 (i huaj) [2020:1].

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1 Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) në Shqipëri. Pavarësisht situatës pandemike, pasojat e së cilës nuk është ende e mundur që të maten me besueshmëri dhe plotësisht për momentin, Shoqëria nuk pret të ketë shmangie kundrejt shumave të buxhetuara për vitin 2022.

Drejtimi i shoqërisë vlerëson se shoqëria do të vijojë aktivitetin normal tregtar për 12 muajt që pasojnë muajin e mbylljes së këtyre pasqyrave financiare. Për rrjedhojë, pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2021 janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.4 Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura ne periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga rivlerësimi.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave



*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

### **3. Politikat kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhën që fillon më 01 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021.

#### **3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit.

Kursi i këmbimit me date 31.12.2021 është 120.76 leke/euro.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **3.2 Instrumenta financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Paraja dhe ekuivalentët e parasë*

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.



*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuara duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuara sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi

### **3.3 Aktive afatgjata materiale**

#### *(i) Njohja dhe matja*

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjate material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.



*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

*(ii) Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*(iii) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivitetit afatgjatë material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi.

### **3.4 Zhvlerësimi**

*(i) Aktivitetet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*(ii) Aktivitetet jo-financiare*

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***3.5 Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

**3.6 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove perkatëse.

**3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

**3.8 Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në periudhën e raportimit.

**4. Të tjera për t'u arkëtuar**

Të tjera për t'u arkëtuar përbëhen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
TVSH e arkëtueshme	901,540	901,540
<b>Totali</b>	<b>901,540</b>	<b>901,540</b>

**5. Llogari të pagueshme**

Llogari të pagueshme përbëhen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Llogari të pagueshme	253,596	103,908



# Emanuelle Adriatic Energy Limited – Dega në Shqipëri e Emanuelle Adriatic Energy Limited Qipro

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare  
për periudhën nga 01 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

<b>Totali</b>	<b>253,596</b>	<b>103,908</b>
---------------	----------------	----------------

## 6. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore përbëhen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	8,370	8,370
<b>Totali</b>	<b>8,370</b>	<b>8,370</b>

Detyrimet ndaj sigurimeve shoqerore dhe shendetesore jane paguar gjate vitit 2022.

## 7. Detyrime te tjera

Detyrime te tjera përbëhet si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Emanuele Energy LTD	6,936,370	6,478,827
<b>Totali</b>	<b>6,936,370</b>	<b>6,478,827</b>

## 8. Rezultati

Rezultati përbëhet si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Humbje e akumuluar	(5,689,565)	(4,922,049)
Humbje e periudhes	(607,230)	(767,516)
<b>Totali</b>	<b>(6,296,796)</b>	<b>(5,689,565)</b>

## 9. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbëhen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>
Paga	40,320	40,320
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	60,120	60,120
<b>Totali</b>	<b>100,440</b>	<b>100,440</b>

## 10. Shpenzime të tjera

Shpenzime të tjera përbëhen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>
--	---	---

# Emanuelle Adriatic Energy Limited – Dega në Shqipëri e

## Emanuelle Adriatic Energy Limited Qipro

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për periudhën nga 01 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Sherbim konsulence	667,997	518,938
Komisione banka	4,100	5,058
Taksa bashkiake	-	51,500
<b>Totali</b>	<b>672,097</b>	<b>575,496</b>

## 11. Të ardhura/(shpenzime) financiare neto

Të ardhurat / (shpenzimet) financiare përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<i>Fitime të perealizuara nga kurset e këmbimit</i>	-	-
<i>Humbje të perealizuara nga kurset e këmbimit</i>	165,307	(91,581)
	<b>165,307</b>	<b>(91,581)</b>
<i>Fitime të realizuara nga kurset e këmbimit</i>	-	-
<i>Humbje të realizuara nga kurset e këmbimit</i>	-	-
	-	-
<b>Totali</b>	<b>165,307</b>	<b>(91,581)</b>

## 12. Tatim fitimi

Tatim fitimi përbëhet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<b>Fitimi kontabel (humbja)</b>	<b>(607,230)</b>	<b>(767,516)</b>
<b>Shpenzime te panjohura sipas ligjit fiskal</b>		
Shpenzime te tjera	-	-
Gjoba dhe penalitete	-	-
<b>Totali I shpenzimeve te panjohura</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Fitimi I tatueshem</b>	<b>(607,230)</b>	<b>(767,516)</b>
Humbje e mbartur	<b>(5,689,565)</b>	<b>(4,922,049)</b>
<i>Humbja fiskale per tu mbartur</i>	(6,296,796)	(5,689,565)

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2021 [2020:15%].

Deklaratat tatimore dorëzohen cdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

### **13. Angazhime dhe pasiguri**

Gjatë aktivitetit normal të biznesit, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime të ndryshme nga të tretë dhe masa ligjore. Vecanerisht, legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri në fuqi ose që konsiderohet si i hyrë në fuqi në fund të periudhës raportuese, është objekt i interpretimeve të ndryshme për sa i përket zbatimit të tij për transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor ndërmarrë nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbështet qëndrimet tatimore mund të kundërshtohet me sukses nga autoritetet përkatëse.

Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga autoritetet për pesë vite kalendarike para vitit të shqyrtimit. Nën rrethana të caktuara shqyrtimet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

Më 31 dhjetor 2021, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale apo operationale të kontraktuara por ende të papaguara.

### **14. Ngjarje të mëpasshme**

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.